



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:284611

Datë: 06.05.2024

Numri i dokumentit: 05655906

E.nr. 120/07

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Sabaheta Kurteshi, duke vendosur në lëndën e përmbartimore të kreditorit N. S. nga fshati..., Komuna e Dragashit kundër debitorit B. S. fsh...., Komuna e Dragashit, lidhur me propozimin për përmbartimin e ujdisë gjyqësore – shpenzimeve të procedurës në shumë prej 500,00 €, më datë 03.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPREHET procedura në këtë çështje juridike, për shkak të vdekjes së debitorit **B. S. nga fsh...., Komuna e Dragashit**

II. Procedura mund të vazhdohet me propozimin e kreditorit në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të këtij Aktvendimi ndaj trashëgimtarëve të debitorit si dhe në afat prej 7 dite mundë të paraqet propozim për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm nga radha e trashëgimtarëve të debitorit nga dita e dorëzimit të këtij Aktvendimit.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Themelore në Prizren – Dega në Dragash është iniciuar procedura përmbartimore të kreditorit N. S. nga fshati..., Komuna e Dragashit kundër debitorit B. S. nga fsh...., Komuna e Dragashit, lidhur me propozimin për përmbartimin e ujdisë gjyqësore –shpenzimeve të procedurës në shumë prej 500,00 €.

Gjykata që nga dorëzimi i propozimit e deri me tani disa herë e ka ftuar palët, ashtu që me dt. 29.04.2024 gjykata është njoftuar se debitori ka ndërruar jetë me datë 20.12.2019.

Me dt. 29.04.2024 gjykata ka pranuar një kopje të Certifikatës së vdekjes nga ana e zyrës së gjendjes civile në Dragash në kërkesë të gjykatës.

Deri me tani nuk kemi ndonjë njoftim nga kreditori se kush janë trashëgimtarët e debitorit, nuk ka ndonjë parashtrësë.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provës së lartpërmendur në bazë të cilës u vërtetua se debitori ka vdekur dhe duke marr parasysh se i njëjti nuk ka pas të autorizuar si dhe duke marr parasysh që në këtë çështje interesi është i kreditorit pasi që i njëjti ka paraqitur propozimin për përmbarim si më lartë .

Andaj gjykata konform dispozitave ligjore të Ligjit të procedurës përmbarimore kreditori në rast të vdekjes së debitorit e që nuk ka përfaqësues ligjor apo me prokurë mund ti propozoj gjykatës emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm në emër të trashëgimtarëve të debitorit apo gjykatës ti afroj aktvdekjen e debitorit se kush janë trashëgimtarët dhe të precizohet propozimi për përmbarim në emër të trashëgimtarëve me qëllim të caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm nga trashëgimtarët e debitori apo përfaqësuese sipas detyrës zyrtare në ngarkesë të shpenzimeve të kreditorit.

Duke u bazuar në nenin 35 par. 1 lidhur me par. 4 të Ligjit për procedurën përmbarimore, gjykata konstatoi se procedura në këtë çështje juridike duhet të ndërpritet.

Andaj, nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2022:284611, 03.05.2024**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.